

Në bazë të nenit 24, paragrafi (1), pika 1), nënpika 16) të Ligjit të Energjetikës* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19), nenit 8 të Rregullores së Formulimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse të Transportit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/20 dhe 133/20) dhe vendimit për përcaktimin e dendësisë së përshkallëzuar ρ_e dhe dendësisë së pashkallëzuar ρ_d të secilit derivat të naftës dhe të lëndës djegëse të transportit, të shumës së kompensimit P për premi, të shpenzimeve të transportit T, te depozita në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të shumës së kompensimit D të shpenzimeve të punës, nëpërmjet depozitës dhe marzhës tregtare me shpenzime të përfshira të transportit nga depozita, te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.90/21) Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 12.10.2021, miratoi

V E N D I M

për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit

Neni 1

(1) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit janë:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	75,50 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	77,50 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	67,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	67,00 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	42,761 (denarë/kilogram)

(2) Tregtarët me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, mund të formulojnë çmime edhe më të ulëta të derivateve të ndryshme të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, se çmimet më të larta të përcaktuara sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të formuluara sipas paragrafit (1) të këtij neni, përveç çmimit të mazutit M-1 SU, vlejnë për franko stacionet e pompimit, ndërkaq çmimi i Mazutit M-1 SU vlen për deponime franko të tregtarit me shumicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit brenda vendit.

(4) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të formuluara sipas këtij neni, përfshihet edhe tatimi i vlerës së shtuar sipas Ligjit të Tatimit të Vlerës së Shtuar.

Neni 2

(1) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, janë përfshirë edhe çmimet më të larta të blerjes, të cilat arrijnë vlerën prej:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	34,872 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	36,561 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	34,914 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	34,571 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	32,848 (denarë/kilogram)

Neni 3

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është përfshirë edhe kompensimi i shpenzimeve të punës, nëpërmjet depos dhe marzhës tregtare, që për Eurosuperin BS-95 është 5,391 denarë/litër, për Eurosuperin BS-98 është 5,397 denarë/litër, për Eurodizelin BS (D-E V) është 5,709 denarë/litër dhe për Vajin Ekstra të Lehtë 1 (EL-1) është 5,619 denarë/litër, ndërsa për Mazutin M-1 SU kompensimi është 2,500 denarë/kilogram.

Neni 4

Çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, me përjashtim të Mazutit M-1 SU, përfshijnë edhe kompensimin e shpenzimeve të transportit, nga depoja te pompat e benzinës, në vlerë prej 0,75 denarë/litër për të gjitha derivatet e naftës.

Neni 5

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i përfshirë edhe kompensimi i financimit të aktiviteteve të fushës së mjedisit jetësor, që sipas nenit 184, paragrafi (1), të Ligjit të Mjedisit Jetësor, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	0,080 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	0,080 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,030 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	0,040 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,050 (denarë/kilogram)

Neni 6

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është përfshirë edhe kompensimi i rezervave të detyrueshme të naftës dhe të derivateve të naftës, të cilin në pajtueshmëri me nenin 24, paragrafi (3) të Ligjit të Rezervave të Detyrueshme të Naftës dhe të Derivateve të Naftës, e paguajnë tatimpaguesit gjatë importit dhe/ose prodhimit të derivateve të naftës:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	0,890 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	0,890 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,300 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	0,300 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,740 (denarë/kilogram)

Neni 7

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, akcizat që i paguajnë tatimpaguesit në pajtueshmëri me rregullat e akcizave kanë këto vlera:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	22,00 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	22,00 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	15,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	15,50 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,100 (denarë/kilogram)

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, ndërkaq do të fillojë të zbatohet në orën 00:01 të datës 13.10.2021 dhe do të botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ARSYETIM

Me këtë vendim bëhet rritja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës, për mesatarisht 3,41 %, në raport me çmimet e shitjes me pakicë të derivateve të naftës, të përcaktuara sipas vendimit për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të

Komisionit Rregulator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut datë 4.10.2021.

Çmimet referente të derivateve të naftës në tregun botëror, në krahasim me periudhën e kaluar shtatëditore, shënojnë rritje të benzina, mesatarisht 4,632 % ose 34,350 \$/tonelatë, të naftës ka rritje mesatarisht 5,931% apo 39,400 \$/tonelatë, të vaji ekstra i lehtë ka rritje me një mesatare prej 6,115 % apo 40,000 \$/tonelatë dhe të mazutit ka rritje mesatarisht për 4,333 % apo 22,100 \$/tonelatë, për shkak se në strukturën e çmimeve të derivateve të naftës është bërë përshtatje përkatëse.

Kursi i denarit, në raport me dollarin në periudhën e kaluar shtatëditore, ka qenë 53,2298 den/\$dhe është për 0,650% më i lartë se kursi i dollarit (52,8860 den/\$) sipas të cilit janë formuluar çmimet e përlogaritjes së mëparshme.

Duke pasur parasysh ndikimet e këtyre elementeve në formimin e çmimeve të derivateve të naftës sipas Metodologjisë, **çmimet e shitjes me pakicë të derivateve të naftës në përputhje me Metodologjinë e formimit të çmimeve rriten mesatarisht për 3,41 %.**

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 rriten për 2,00 denarë/litër, në raport me çmimet e shitjes me pakicë, të përcaktuara me vendimin e përcaktimit të çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të datës 4.10.2021, kështu që çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPERIT BS-95 është 75,50 den/litër, ndërsa çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPERIT BS-98 është 77,50 den/lit.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT (D-E V) dhe të Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1), rriten për 2,50 denarë/litër, në raport me çmimet e shitjes me pakicë, të përcaktuara me vendimin për përcaktimin e çmimeve më të larta të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse për transport të datës 4.10.2021 kështu që çmimi i shitjes me pakicë i EURODIZELIT (D-E V) është 67,50 den/lit, ndërsa çmimi i shitjes me pakicë i VAJIT EKSTRA TË LEHTË PËR AMVISËRI (EL-1), është 67,00 den/lit.

Çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU rritet për 1,630 denarë/kg, në raport me çmimin e shitjes me pakicë, të përcaktuar me vendimin e përcaktimit të çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të datës 4.10.2021, kështu që çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU është 42,761 den/kg.

Akcizat e derivateve të naftës, në të gjitha grupet e çmimeve të shitjes me pakicë, janë përcaktuar në përputhje me Ligjin e Akcizave. Çmimet e shitjes me pakicë, të përcaktuara me këtë vendim, përmbajnë: kompensimin e financimit të aktiviteteve në fushën e mjedisit jetësor, që sipas Ligjit të Mjedisit Jetësor, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj dhe kompensimin e rezervave të detyrueshme të naftës dhe të derivateve të naftës, që sipas Ligjit të Rezervave të Detyrueshme të Naftës dhe të Derivateve të Naftës, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj, gjatë importit dhe/ose prodhimit të derivateve të naftës.

**Nr. 02-1876/1
12.10.2021**

S h k u p

**Kryetar i Komisionit Rregulator të Energjetikës
dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së
Maqedonisë së Veriut**

Марко Бислимоски